



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC**

Numri i lëndës: 2024:073487

Datë: 08.07.2024

Numri i dokumentit: 05907378

PPP.nr.05/2024

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, gjyqtari Berkan Hamza, në çështjen juridike të përmbarimit, sipas propozimit për përmbarim të kreditorit H.K nga fshati Ratkoc, Komuna e Rahovecit, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokati S.M nga Prizreni, kundër debitorit të përmbarimit Komuna e Rahovecit, Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson avokati B.O nga Rahoveci, lidhur me përmbarimin e dokumentit përmbarues aktgjykimit të Gjykatës Themelore Gjakovë – Dega në Rahovec C.nr.718/2022, të datës 24.01.2022, i plotfuqishëm nga data 09.02.2024, ndërsa i ekzekutueshëm nga data 31.01.2024, i lejuar me urdhrin për përmbarim P.nr.294/24, i datës 21.02.2024, të përmbaruesit privat R.H nga Prizreni, duke vendosur sipas propësimit të debitorit të përmbarimit, jashtë seancës gjyqësore, më datë 08.07.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

I. REFUZOHET i pabazuar propësimi i debitorit të përmbarimit Komuna e Rahovecit, Drejtoria Komunale e Arsimit, ushtruar kundër urdhrin për përmbarim, P.nr.294/24, i datës 21.02.2024 të përmbaruesit privat, R.H nga Prizreni, ndërsa MBETET në fuqi i njëjti urdhër për përmbarim.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e përmbarimit në këtë çështje juridike të përmbarimit përveç se deri në përfundimin e procedurës në këtë çështje juridike të përmbarimit, të gjitha shpenzimet e përmbarimit, do t'i bartë ajo palë e cila e humb procesin gjyqësor – përmbarimor.

III. Ankesa kundër këtij aktvendimi nuk e ndalon procedurën përmbarimore, përveç nëse janë dhënë garancitë për shumën e plotë të kredisë, konform nenit 78 të LPP-së.

**A r s y e t i m**

Organi i përmbarimit, përmbaruesi privat R.H nga Prizreni, ka caktuar përmbarimin sipas urdhrin për përmbarim P.nr.294/24, të datës 21.02.2024, në bazë të dokumentit përmbarimor aktgjykimit të Gjykatës Themelore Gjakovë – Dega në Rahovec me numër C.nr.718/2022, të datës 24.01.2022, i plotfuqishëm nga data 09.02.2024, ndërsa i ekzekutueshëm nga data

31.01.2024, kundër debitorit të përbarimit Komuna e Rahovecit, lidhur me kompensimin e shpenzimeve të ushqimit në shumë prej 1,314.00 euro si dhe në emër të kompensimit të shpenzimeve të procedurës kontestimore shumë prej 117.00 euro, të caktuar sipas aktgjykimit të lartpërmendur të kësaj gjykate.

Kundër urdhrin me të cilin është caktuar përbarimi, debitori, përmes përfaqësuesit të saj të autorizuar, brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim me të cilin e ka kontestuar urdhrin për lejimin e përbarimit, me pretendimin se me aktgjykimin C.nr.199/2021 të datës 15.05.2023 i është kreditorit i është aprovuar kërkesëpapia për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit për periudhën prej 05.12.2019 deri më 18.04.2021.

Kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësim me datë 29.02.2024, duke cekur se gjykata në procedurën përbarimore nuk mundet që dokumentin përbarues (titulus executionis) ta ndryshoj, apo ta shfuqizojë urdhrin përbarimor në kuptim të nenit 71 par.1 pika 1.8 të LPP-së.

Gjykata pas shqyrtimit të propozimit të kreditores, urdhrin për caktimin e përbarimit, prapësimin të debitorit, përgjigjes në prapësim, si dhe shkresave tjera të lëndës ka ardhur në përfundim se prapësimi i debitorit është i pabazuar.

Gjykata me analizimin e propozimit për përbarim P.nr.294/24, të datës 21.02.2024, aktgjykimit të Gjykatës Themelore Gjakovë – Dega në Rahovec, C.nr.718/2022, të datës 09.01.2024, i plotfuqishëm nga data 31.01.2024, ndërsa i ekzekutueshëm nga data 09.02.2024, ka ardhur në përfundim se sipas këtij aktgjykimi, debitori është i detyruar që kreditores në emër të kompensimit për shpenzimet e ushqimit t'ia paguajë shumë prej 1,314.00 euro me kamatë ligjore 8% duke filluar nga dita e ushtrimit të padisë më datën 17.12.2019, e deri në pagesën përfundimtare. Gjykata vlerëson se dokumenti përbarues, aktgjykimi C.nr.718/2022, i përmbush të gjitha kushtet ligjore konform LPP-së nenit 22 par.1 nënpar.1.1, nenit 23 par.1 dhe nenit 24 par.1 në të cilët përcaktohet se (neni 22 par.1 nënpar.1.2) *”Dokumente përbaruese janë: 1.2. vendimi përbarues i Gjykatës dhe ujdia (pajtimi) gjyqësore përbarues”, neni 23 par.1* *”Sipas këtij ligji, vendim gjyqësor konsiderohet aktgjykimi, aktvendimi, si dhe vendimi tjetër i dhënë në procedurën gjyqësore.....”, neni 24 par.1* *“Vendimi gjyqësor me të cilin është urdhëruar përmbushja e kredisë për ndonjë dhënie apo bërje, është i përbarueshem po që se ka marrë formë të prerë, si dhe po që se ka skaduar afati për përmbushje vullnetare. Ndërsa në nenin 27 par.1 përcaktohet se ”Dokumenti përbarimor është i përshatshëm për përbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”. Nga kjo rezulton se vendimi në fjalë është titull përbarimor sepse i njëjti ka marrë formën e prerë, ka të përcaktuar kreditorët dhe debitorët, kohën e përmbushjes së detyrimit, dhe shumën e përmbushjes. Për këto arsye gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.*

Sa i përket pretendimit të palës debitore se për periudhën e njëjtë i njëjti është kompensuar me aktgjykimin me numër C.nr.199/2021 të datës 18.05.2023, për gjykatën ky pretendim është i paqëndrueshëm për faktin se në procedurën përbarimore gjykata është e lidhur me dokumentin përbarimor dhe vlerën parimi rigoroz formal, ndërsa çështjet e ngritura nga pala debitore, si të drejta subjektive mund të realizohen në procedurën kontestimore.

Nga ajo që u tha më lartë, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 22 par.1 nënpar.1.1, neni 23 par.1, 24 par.1, neni 27 par.1, neni 71,73 neni 77 par.1, të Ligjit për Procedurën Përmbaremore, si dhe nenit 382 par.1 të LMD-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC  
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil  
PPP.nr.05/2024, me datë 08.07.2024

Gjyqtari  
Berkan Hamza

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 (shtatë) ditëve, nga dita e pranimit. Ankesa ushtrohet përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.